

LIGJ
Nr.7711, datë 20.5.1993

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7636, DATË 12.11.1992 "PËR DISA NDRYSHIME
NË DEKRETIN NR.7458, DATË 22.1.1991 "PËR TË DREJTËN E GREVËS" DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7673, DATË 17.2.1993 "PËR KONTRATËN KOLEKTIVE TË
PUNËS"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 3 i dekretit nr.7458, datë 22.1.1991 "Për të drejtën e grevës", ndryshohet si vijon:

1. E drejta e grevës ushtrohet për përmirësimin e kushteve të punës, shpërblimin e punës, mbrojtjen në punë, sigurimet shoqërore, si dhe për të drejta të tjera që lidhen me marrëdhëniet e punës, me qëllim që të arrihet nënshkrimi i kontratës kolektive.

2. E drejta e grevës ushtrohet edhe pas nënshkrimit të kontratës, por pas ndërmjetësimit për zgjidhjen e konfliktit midis palëve.

Neni 2

Në nenin 6 të dekretit nr.7458, datë 22.1.1991 "Për të drejtën e grevës", hiqet pika "e" me këtë përmbajtje: "për kërkesa që nuk janë të bazuara në kontratën kolektive të punës".

Neni 3

Paragrafi i fundit i nenit 6, të dekretit nr.7458, datë 22.1.1991 "Për të drejtën e grevës", ndryshohet si vijon:

"Greva e filluar në kundërshtim me gërmat "a", "b", "c", "ç", "d", "dh", "ë" të këtij neni është e paligjshme".

Neni 4

Neni 9 i dekretit nr.7458, datë 22.1.1991 "Për të drejtën e grevës" ndryshohet si më poshtë:

"Kur greva shoqërohet me veprime të paligjshme, palët i drejtohen gjykatës. Gjykata përcakton përgjegjësinë e palëve, veprimet që ato duhet të kryejnë, dhe kur ka pasoja financiare, cakton palën që detyrohet të zhdëmtojë".

Neni 5

Neni 21, paragrafi i parë i ligjit 7673, datë 17.2.1993 "Për kontratat kolektive të punës" ndryshohet si vijon:

"Kur gjatë kohës së zbatimit të kontratës kolektive të punës ndryshojnë kushtet reale, palët kontraktuese mund t'i bëjnë asaj ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme me marrëveshje midis tyre".

Neni 6

Pas nenit 21 të ligjit nr.7673, datë 17.2.1993 "Për kontratat kolektive të punës", shtohet neni

21/a me këtë përmbajtje:

"Nëse palët nuk bien dakord për të ndryshuar ose plotësuar kushtet e kontratës kolektive, ato duhet të zhvillojnë bisedime midis tyre për zgjidhjen e konfliktit, brenda 15 ditëve nga dita e marrjes së propozimit me shkrim për ndryshimin ose plotësimin e kontratës.

Nëse bisedimet nuk janë të suksesshme kontrata kolektive ekzistuese përfundon automatikisht. Për zgjidhjen e konfliktit palët ndjekin procedurat e parashikuara në nenet 17 dhe 17/a".

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr,551, datë 5.6.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.